

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësor edhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Ragip Namani, dhe Nebojša Boričić ,anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të palës ankuese:

S. R. D. nga Komuna Pejë

Paraqitësi e ankesës,

Kundër: Xh.F., nga R. Mali i Zi

Paraqitësi kërkesës- përgjegjës në ankesë

Duke vendosur në lidhje me Ankesën e përsëritur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/119/2011, të dt. 07.09.2011, lënda e regjistruar në AKP me numër KPA17575, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27 Mars 2019, merr këtë:

AKTVENDIM

Hedhet Poshtë si e palejuar Ankesa e përsëritur, e parashtruar nga S. R. D., kundër Vendimit KKPK/D/A/119/2011, të datës 07 Shtator 2011, lënda e regjistruar në AKP me numër, KPA17575.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 23 Nëntor 2007 Xh. F., ka depozituar një kërkesë të regjistruara në AKP KPA17575, në cilësinë e djalit të titullarit të pretenduar të së drejtës pronësore në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar të drejtën e ri posedimit. Ai pretendon se babai i tij i ndjerë Adem Ferizi është i regjistruar si pronar i ngastrës 130, sipas fletës poseduese ... të Zonës Kadastrale ... ,Komuna e Pejë.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Letërnjoftimin të lëshuar me datë 29 shtator 2002, nga organi kompetent i Komunës së Nikshiqit, R. Malit të Zi.
 - Fleta Poseduese nr. ... i datës 20.5.2005, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronësi të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Pejës nr...,me të cilën konstatohet se ngastra ... që gjendet në vendin e quajture “Gorazhdevackopole “ me kulturë arë klasës së 5 në sipërfaqe prej 1.31.01ha., është e regjistruar në emrin A. F.

- Aktvdekjen e dt.08 tetor 2007, me të cilën konstatohet se A. F. ka vdekur me 01 Shtator 1996.
 - Ekstrakti nga libri amzë i të lindurve të lëshuar nga organi kompetent i N..., R. e Malit të Zi, dt.08 tetor 2007, Xh. F., është djali i A. F.
3. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronën e kërkuar, me vendimin e tij KKPK/D/A/119/12 datë 07 shtator 2011, ka vendosur që paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se A. F., është pronar me 1/1, i pronës së kërkuar dhe se Xh. F., ka të drejtën në posedimin të kësaj prone të paluajtshme. Në arsyetimin e vendimit ankimor është konstatuar se paraqitësi i kësaj kërkesë ka paraqitur prova juridikisht të vlefshme që vërtetojnë se babai i tij i ndjerë, është pronar i pjesës ideale për 1/1, të pronës të kërkuar. Përpos kësaj këtë pronë të paluajtshme askush nuk e ka kontestuar. Po kështu pamundësia e ushtrimit të drejtës pronësore ndërlihdet me rrethanat që direkt rezultojnë apo janë të ndërlihdura me konfliktin e armatosur në vitin 1998/99.
 4. Kundër Vendimit të lartë cekur të KKPK-së, S. D, të cilin e kishte pranuar me 26 Mars 2013, me datë, 04 Prill 2013, kishte ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës.
 5. Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji për shqyrtimin e ankesave kundër Vendimeve të AKP-së, duke vendosur lidhur me ankesën e palës ankuese S. D., paraqitur Kundër Vendimit KKPK/D/A/119/2011, të dt. 07 Shtator 2011, për lëndën e regjistruar në AKP me numër KPA17575, në seancën e saj të mbajtur me datë 18 Nëntor 2014, merr Aktgjykimin nr. GSK-KPA-A-79/13 me datë 18 Nëntor 2014, me të cilin Ankesa e tij Refuzohet si e pa bazuar ,ndërsa konfirmohet si i drejtë dhe ligjor Vendimi KKPK/D/A/119/2011, i dt. 07 Shtator 2011, (KPA17575).
 6. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi ndër të tjera thuhet se , Vendimi i ankimuar mbështet mbi bazën e vërtetimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike me ç ‘rast drejt janë zbatuar dispozitat e të drejtës materiale dhe i njëjti nuk është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimeve të cilat janë me ndikim në drejtshmërinë, ligjshmërinë dhe rregullsinë e këtij vendimi. KKPK tërësisht dhe saktësisht i ka vërtetuar faktet relevante që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm kur ka vendosur që t’ia pranoj të drejtën e pronës dhe ri posedimit të ngastrës së theksuar Xh. F., për arsye se, sipas fletës poseduese nr. ..., të datës 20.05.2005, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronësi të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Pejës, konstatohet se ngastra kadatrale numër ..., Zona Kadastrale ..., që gjendet në vendin e quajture “Gorazhdevackopole”, me kulturë arë klasës së 5 ,në sipërfaqe prej 1.31.01ha, është e regjistruar në emrin e prindit të tij A. F.
 7. Gjykata Supreme e Kosovës pasi kishte vendosur, Aktgjykimin e saj GSK-KPA-A-79/13, si dhe komplet lëndën ja ka dorëzuar AKP-së ,duke u mbështetur në dispozitën e nenit 12.12.të

Rregullores së UNMIK,2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ndërsa Sekretaria e AKP-së, i kishte dorëzuar aktgjykimin përfundimtar palës ankuese.

8. Me datë 25.06.2015, Sali R. Demaj, ka paraqitur përsëri ankesë kundër Vendimit të njëjtë të AKP-së, sipas numrit të saj KPA17575, të cilin e konteston në tëri si të kundërligjshëm. Ankesës i bashkëngjit prova të reja Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.315/13, dt.12.12.2014, Certifikatën e Pronësisë për ngastrën kadastrale nr. 130, Z.K. ..., të dt.27.01.2015, dhe kopjen e planit për ngastrën e njëjtë, në bazë të cilave dokumente kjo ngastër është në emër të pronarit S.R. D.

Arsyetimi ligjor

1. Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtoi ankesën si dhe shkresat e kësaj lënde gjen se, ankesa e dytë kundër Vendimit të njëjtë të AKP-së, është e pa lejuar dhe si e tillë duhet hedhur poshtë, sepse kjo çështje është përfunduar duke u vendosur me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Supreme GSK-KPA-A-79/13, të dt. 18 Nëntor 2014, sipas ankesës së parë të palës ankuese, të paraqitur me datë 04 Prill 2013, kundër Vendimit të njëjtë KKPK/D/A/119/2011, dt.07 Shtator 2011, (lënda e regjistruar në AKP, me numër KPA 17575). Në arsyetimin e Aktgjykimit të dt. 07.09.2011, në paragrafin e fundit “**Këshillë ligjore**”, është cekur se “në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.
2. Prandaj Gjykata konstaton se Vendimi i AKP-së, i konfirmuar si i drejtë dhe ligjor në procedurë ankimore, me aktgjykimin përfundimtar në Gjykatën Supreme, nuk mund të shqyrtohet prapë sepse këtë e pamundësojnë qartazi dispozitat ligjore të nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, dhe për këto arsye Gjykata nuk shqyrtoi fare meritat e ankesës por vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-016-2015 & GSK-KPA-A-79/13, me datë 27 Mars 2019

Bashkp. Profesional
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit
Beshir Islami